



REPUBLIKA E KOSOVËS
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D
Nr. Prot. 01-1235/13
Data 23.04.2013



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit (Gazeta Zyrtare Nr. 65, datë 05.02.2010), nenin 11 (paragrafi 1) të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil, (Gazeta Zyrtare Nr. 72, datë 25.06.2010) si dhe në nenin 34 (paragrafi 5) të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, (MAP 20.09.2010), Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 22.04.2013, mori:

V E N D I M

1. Anulohet procedura e rekrutimit për pozitat e karrierës Zyrtar i Lartë për Parandalimin e Konfliktit të Interesit (dy pozita), shpallur me datë 19.02.2013 dhe Zyrtar i Lartë për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Korrupsionit (një pozitë), shpallur me datë 21.02.2013.
2. Obligohet Zyra e Personelit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Vendimi merret në pajtim me nenin 11 (paragrafi 1) të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil dhe nenin 34 (paragrafi 5) të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, duke u bazuar në dokumentacionin e ofruar nga Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil sipas të cilit asnjë nga kandidatët për pozitat e lartcekura nuk i ka plotësuar kushtet për seleksionim, andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Hasan PRETENI

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit



Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Zyrës së Drejtorit;
- Zyrës Ligjore;
- Zyrës së Personelit;
- Arkivit.